REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 75/17
Datë/Datum. 03.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: **KRU HIDROMORAVA SH.A – GJILAN.**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - **OSHP Nr.75/17**
Nga:	Basri Fazliu - Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën **"Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në regjionin e Gjilanit – zonat rurale Lot-1",** me nr. prokurimi: KRU**2016/016/521.**		
Përgjigjeje në ankesë:	**OE "Arlindi & Berisha Compani" sh.p.k, Ferizaj.**		
Datë	**03.04.2017**		

Bazuar në nenin 113.1 të LPP-së ju njoftojmë me ekspertizën e lëndës lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në regjionin e Gjilanit – zonat rurale Lot-1",** me nr. prokurimi: KRU**2016/016/521,** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KRU HIDROMORAVA SH.A – GJILAN,** dhe me përgjigjeje ndaj ankesës së operatorit ekonomik: OE **"Arlindi sh.p.k &Berisha Company"**, me seli në – Ferizaj, me nr.prot.75/17, i datës **15.03.2017**

Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i pavarur, ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

RAPORTI MBI EKSPERTIZËN E EKSPERTIT SHQYRTUES:

		23.03.2017		24.03.2017		03.04.2017
Nënshkrimi i ekspertit		Data e pranimit të autorizimit		data e fillimit të ekspertizës		data e dorëzimit të raportit të ekspertizës

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit.

Me datë: 15.03.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën me numër të protokollit 75/17 e parashtruar nga operatori ekonomik në konz. "Arlindi sh.p.k & Berisha Company sh.a" – Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në regjionin e Gjilanit – zonat rurale Lot-1", me nr. prokurimi: KRU2016/016/521", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KRU HIDROMORAVA sh.a - Gjilan.
Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si më poshtë:

N. 111,-Operatori Ekonomik Ankues: "Arlindi" sh.p.k & "Berisha Company sh.a" – Ferizaj.

Pika e ankesës:

OE ankues ka paraqitur pretendimet ankimor kundër anulimit të aktivitetit të Prokurimit por NUK ka paraqitur në ankes ndonjë dispozit konkrete të Ligjit për prokurim public që nuk është respektuar.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Në njoftimin për kontrat thuhet se vlera e parashikuar për këtë aktivitet të Prokurimit (Lot-1) është vlera 230,000.00€, ndërsa ne si konzercium "Arlindi sh.p.k & Berisha Company sh.a", kemi ofertuar me çmim prej 215,236.59€. Ne mendojm se na bëhet e padrejt për arsye se nuk besojm në konkludimin nga ana e CDI-se ku thuhet se sasitë e përfshira në dokumente e tenderit janë të tepërta në krahasim me vlerësimin teknik dhe e tejkalojn buxhetin në dispozicion të programit RËSSP-V.

Ne nuk jemi njoftuar me shkrim nga ana e AK-së Hidromorava sh.a – Gjilan, për anulimin si dhe njoftimin për anulim në KRPP, të publikuar më 07.03.2017, nuk thuhet asnjë përveq që bëjmë anulimin e aktivitetit të Prokurimit me rekomandim të CDI-së.

Ne kërkojmë nga OSHP, që këtë aktivitet të Prokurimit të ri-kthehet në rivlerësim sepse na është bërë e padrejt sepse dokumentet në dosjen e tenderit të gjitha janë të regulluar sipas specifikacioneve në dosjen e tenderit dhe për këtë arsyje kërkohet anulimi i këtij aktiviteti të Prokurimit vetëm që ne mos të jemi kompani fituese.

Procesi i prokurimit:

Raporti i ekspertit shqyrtues për lëndën: **"Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në regjionin e Gjilanit – zonat rurale Lot-1",** me nr. prokurimi: KRU**2016/016/521,** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KRU HIDROMORAVA SH.A – GJILAN.**

Data e njoftimit në KRPP-së për kontratë (N.35) :	27.12.2016
Lloji i procedurës së aplikuar (N.32-35):	Procedur e hapur/vlerë e mesme
Lloji i kontratës së publikuar(N.16):	Punë
Afati i fundit për pranim të tenderëve:	19.01.2017
Data e Hapjes së ofertave:	19.01.2017, ora 14;30h
Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit në KRPP:	03.03.2017
Kriter për dhënien e kontratës:	*Tenderi përgjegjshëm, çmimi më i ulët*

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N.58):

Nr.	Tenderuesi	Vendi	Lote	Çmimi	Vëretje
1	ARLINDI&BERISHA COMPANY	FERIZAJ	1	215,236.59€	JO
2	ALFA. I	PRISHTINË	1	218,323.34€	JO
3	ENGINNERING&KUSHTRIMI	VITI	1	424,802.33€	JO

Në këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar TRE (3) operator ekonomik, në procesverbal të hapjes NUK është rexhistruar vërejtje në lidhje me hapjen e ofertave.

Kriteret për kualifikim:

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr 04 \ L-42. LPP i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 mund të shkarkohet nga http://krpp.rks-gov.net.

2. Vertetim i nenshkruar nga Administrata tatimore e vendit tuaj te themelimit se nuk jeni ne vonese per pagimin e tatimeve se paku deri ne tre mujorin e fundit perpara dates se dorezimit te tenderit-*Per kompanin fituse para nenshkrimit te kontrates*

3.Dokument apo vertetim se nuk është me vonese ne pagesen e taksave komunale
4. Dokument apo vertetim që nuk ka konteste gjyqsore ne Gjykaten Ekonomike

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Evidenca:1.Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit- Aneksi 2-Origjinal.

Evidenca:2.Vërtetimi nga Administrata Tatimore ,për OE të rekomanduar për kontratë,para dhënies së kontratës. Origjinali

Evidenca:3.Vertetim apo dokument nga Komuna se nuk ka borgje per taksa komunale,para dhenjes se kontrates, origjinali

Evidenca: 4, Vertetim apo dokument nga Gjykata ekonomike qe nuk eshte ne falimentim apo ne kontest gjyqsore. (nga gjyk.ekonomike , per fituesin e kontrates-origjinali.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:
1. *Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;*
2.Regjistrimi i TVSH (Çertifikata e TVSH)
3.Çertifikata e Numrit Fiskal -

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
1 *Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit);*
2. Çertifikata e TVSH -kopje
3.Çertifikata e Numrit Fiskal - kopje

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:
Për-LOT -l –
Kërkesa 1: Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i OE gjat tri viteve të fundit (2013, 2014, 2015) ka qen prej jo më pak se 375.000,00 €
Kerkesa 2-Deklerata vjetore financiare (pasqyrat finnaciare) e dorezuar në ATK

Për-Lot II-
Kërkesa 1: Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i OE gjat tri viteve të fundit (2013, 2014, 2015) ka qen prej jo më pak se 30.000,00 €
Kerkesa 2-Deklerata vjetore financiare (pasqyrat finnaciare) e dorezuar në ATK

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Per-Loto (1)
Dëshmija 1: Pasqyra e qarkullimit financiar nga një ose më shum banka, ose një dëshmi tjetër nga e cila shifet qartë se OE ka realizuar qarkullim financiar të paktën për tri vitet e fundit (2013, 2014, 2015) të cilat duhet të jenë jo më të ulta se : 375,000.00 €.

Deshmija 2 : Deklarata vjetore(pasqyrat finnaciare) nga ATK-ja te sjellet origjinali-per vitin 2015

Per-Lot -II-

Dëshmija 1: Pasqyra e qarkullimit financiar nga një ose më shum banka, ose një dëshmi tjetër nga e cila shifet qartë se OE ka realizuar qarkullim financiar të paktën për tri vitet e fundit (2013, 2014, 2015) të cilat duhet të jenë jo më të ulta se .30.000,00 €.
Deshmija 2 : Deklarata vjetore(pasqyrat finnaciare) nga ATK-ja te sjellet origjinali-per vitin- 2015.

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional :
Per Lot-l -
Kerkesa-1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses
Punët e natyrës të kësaj kontrate gjatë tre viteve të fundit (-2013-2014-2015) Vlera e përgjithshme e punëve të natyrës së kontratës nuk duhet të jetë më pak se .375.000,00 €.

Kerkesa-2.OE në kuadër të stafit duht të emëroj menaxherin e projektit i cili duhet të jetë Inxhinier i

diplomuar i Ndërtimtarisë, drejtimi hidro teknikes me së paku tri vite pune në profesion e dëshmuar me diplomën mbi kualifikimin, vërtetimin mbi përvojën në punë, të jetë në listën e të punësuarve ose të ketë marrëveshje bashkëpunimi për këtë projekt

Një Inxh te Hidroteknikes ..... 3 vite ,pervoje pune

Një Inxh,te Ndertimtaris.....3 vite pervoje pune

Një Inxh. te Gjeodozis..... ..... 3 vite pervoje pune

Kerkesa-3.Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose posedim pajisje teknike për realizim të suksesshëm të kontratës minimalisht të ketë

a)Tre kamion të tonazhit jo më pak se 7 -15 ton

b)Tre eskavator(bager) gropues të tonazhit 7-15 ton.

c)Paisjet përkatëse për saldimin e gypave PE

Kerkesa-4 :Operatori Ekonomik (ofertuesi) duhet te ket Certifikat ISO-9001-2008

Per Lot-II

Kerkesa--1(një)

Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses

Punët/mbikqyerje profesionale e natyrës të kësaj kontrate gjatë tre viteve të fundit (2013-2014-2015)

Vlera e përgjithshme e punëve të natyrës së kontratës nuk duhet të jetë më pak se .30.000,00 €.

Kerkesa-2.(dy)

OE në kuadër të stafit duht të ket pes inxhinier te profileve si me poshtë: duhet te emëroj menaxherin e projektit i cili duhet të jetë Ekspert i lëmisë perkatëse me së paku tri vite pune në profesion e dëshmuar me diplomën mbi kualifikimin, vërtetimin mbi përvojën në punë, të jetë në listën e të punësuarve ose të ketë marrëveshje bashkëpunimi për këtë projekt,

Dy Inxh te Hidroteknikes ..... 3 vite ,pervoje pune

Një Inxh,te Ndertimtaris.....3 vite pervoje pune

Një Inxh. te Gjeodozise..... ...3 vite pervoje pune

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Deshmia -1.Lista me të cilën specifikohen të gjitha punët e realizuara të natyrës së kontratës në tri vitet e fundit duke ia bashkuar listën e kontratave me shumat e tyre si dhe referencat përkatëse datën dhe pranuesit ose certifikatën e ekzekutimit te mire te punëve.

Deshmia-2. Vendimi mbi emërimin e projekt menagjerit. Si dhe Lista e stafit ku janë të përfshirë stafi i kërkuar në pikën 2 dhe më gjere,bashkangjitur edhe CV, diplomën , dëshmi mbi përvojën e punes, si dhe kontratën e punës ose të bashkëpunimit për këtë projekt

Deshmia-3.Lista e pajisjeve teknike si dhe dokumentacioni përcjellës mbi pronësinë ose marrjen në shfrytëzim të pajisjeve dhe librezat valide të automjeteve të cilat pajisen me leje të tillë.(me qera apo ne shfrytzim)

Deshmija 4: Te sjellet certifikata per ndertim - ISO-standard 9001-2018-kopje

Verejteje per loto II ,duhet te plotsohet kerkesa 1 dhe 2 (Deshmija 1 dhe 2).

Përgjigjje në pretendimet ankimore nga Ekspertit shqyrtues: (N. 113.1), konform njoftimit të OSHP-së të datës 19.11.2014, nr.prot.848/14:

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të lëndës së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në dokumentacionin që kanë pasur në dispozicion eksperti shqyrtues jep mendimin si në vijim:

Eksperti shqyrtues sqaron:
Autoriteti kontraktues gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedur të hapur/lloji kontratës punë, kriter për dhënie të kontratës ka qenë: "Tenderi përgjegjshëm çmimi më i ulët". I pakënaqur me njoftimin për anulimin e aktivitetit tër anulimin e aktivitetit të prokurimit të datës 02.03.2017, për këtë aktivitet të prokurimit, operatoret ekonomik ankues, ka parashtruar kërkes për ri-shqyrtim të vendimin fillimisht në Autoritet kontraktues, pastaj duke parashtruar ankes edhe në OSHP, me datë 15.03.2017, me pretendimet ankimore se arsyeja e anulimit të aktivitetit të prokurimit është i kundërligjshem, dhe qëllimi i vetëm i anulimit është sepse oferta jonë e përgjegjshme me çmim më ulët.

Ne interpretim të asaj që u tha më lartë, po sqarojmë se i kemi shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndes, konkretisht ato që lidhen me zbatim të vendimit të lartë përmendur (pretendimeve ankimore) dhe atë si në vijim:

Sqarimi nr.1
Eksperti shqyrtues, njofton Panelin shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket këtij aktiviteti të prokurimit se autoriteti kontraktues pas hapjes së ofertave me datë 03.03.2017 ka bërë publikimin e njoftimit të anulimit të aktivitetit të prokurimit me arsyetimin se një dispozit e LPP-së kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Eksperti shqyrtues gjatë ekzaminimit të shkresave të lendes në lidhje me pretendimin ankimor, vlerëson se NUK qëndron arsyeja e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit, për faktin se Autoriteti kontraktues NUK ka paraqitur provë bindëse në lidhje me specifikimin teknik, por duke u bazuar në shkresën e pranuar nga Investitori CDI, e datës 27 SHKURT 2017, ku thuhet: "***ne kemi rishikuar tenderin e lartë përmendur i cili është publikuar nëpërmjet KRPP-së dhe jemi të shqetësuar se sasitë e përfshira në dokumentet e tenderit janë të tepërta në krahasim me vlerësimin teknik dhe e tejkalojnë buxhetin në dispozicion të programit RËSSP-V. Për këtë arsye ju duhet të anuloni tenderin aktual dhe ti rishikoni edhe njëhere sasitë para se ta ritenderoni punen që duhet ta bëni.***
Ju lutem që paraprakisht të konsultoni me ne dhe të merrni aprovimin për punët që do të realizohen në mënyr që të mos ketë tejkalim buxhetor".

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në këtë shkres vlerëson se NUK qëndron arsye e dhënë në këtë shkresë sa i përket tejkalimit të buxhetit sepse për të njëjtin projekt janë zotuar sipas vlerës së parashikuar 250,000.00€, ndëra oferta e OE ankues NUK e tejkalon vlerën e parashikuar për këtë projekt.
Poashtu sa i përket arsyes të dhënë në këtë shkres në lidhje me atë sa i përket sasive dhe përshkrimit teknik, Eksperti shqyrtues vlerëson se në shkresen e lartë përmendur NUK janë cekur asnjë prej sasive se cilat janë të tepërta dhe cili është përshkrimi teknik konkret, pasi që paramana ekziston e kompletuar.

Eksperti shqyrtues vlerëon se AK-ja ka vepruar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, gjatë anulimit të aktivitetit të prokurimit, pasi që arsye e dhënë NUK qëndron si e tillë, sepse oferta e OE-ve NUK ka tejkaluar vlerën e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues:

Eksperti shqyrtues duke u mbështetur në vlerësimet e lartë cekura, i rekomandon panelit shqyrtues që të APROVOJ si të BAZUAR ankesën OE "Arlindi & Berisha Compani" sh.p.k, me seli në Ferizaj, për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëherit të ANULOJ vendimin "Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, i datës 03.03.2017, me titull: "Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në regjionin e Gjilanit – zonat rurale Lot-1", me nr. prokurimi: KRU2016/016/521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KRU HIDROMORAVA SH.A – GJILAN, dhe lënda të kthehet në RIVLERËSIM për LOT-1.